



NJOFTIM

Qytetar të nderuar, meqenëse tani ndodhemi në sezonin e zjarreve ku mbretërojnë temperatura të larta, mundësia e ndodhjes së zjarreve në pyje dhe parqe nacionale është shumë e mundshme. Me qëllim të shtimit të masave preventive nga aspekti i mbrojtjes ndaj zjarrit si dhe evitimin-pengimin e rreziqeve potenciale nga zjarri në zonat fushore dhe malore duhet ti kushtojmë kujdes të veçantë kësaj dukurie e cila do të kishte për pasojë rrezikimin e jetës se njerëzve, kafshëve dhe dëmtimit të sipërfaqeve fushore-pyjore.

Komuna jonë posedon një sipërfaqe të madhe të kullosave dhe pyjeve po ashtu edhe objekteve të përkohshme të banimit të cilat janë të ndërtuara nga materiali i drurit i cili ndezët lehtë.

Duke u bazuar në këtë luteni që të keni kujdes të veçantë që gjatë qëndrimit në këto zona malore-fushore të ndërmerren këto masa parandaluese:

- Hedhja e cigareve të ndezura në pyje dhe në tokat pyjore;
- Tymosja e bletëve në pyll;
- Ndezja e zjarreve hapura në afërsi dhe brendësi të sipërfaqeve pyjore;
- Lokalizimi dhe shuarja e zjarrit në vende ku zjarri është ndezur për nevoja pikniku;
- Pastrimi dhe djegia e sipërfaqeve bujqësore;
- Përdorimi i tapave të fishekëve të gjahut prej materialit që merr zjarr lehtë;
- Ndalohet kategorikisht ndezja e zjarreve në kullota deri në 500 m në afërsi të pyllit;
- Ndalohet djegia e mbeturinave të masës drusore në pyje.

Këto masa parandaluese janë të obliguar ti ndërmarrin të gjithë qytetarët sepse obligojnë dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera Nr.04/L-027 si dhe Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr.04/L-012.

Për mos respektimin e këtyre masave parandaluese ndaj zjarrit do të ndërmerren masa ndëshkuese nga organet kompetente.

Dëmtimi i pyllit nga zjarri me dashje apo nga pakujdesia, dënohet në bazë të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



DREJTORI
Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe
Shërbime Publike

/ Izet Zenuni /